



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE**

## **RELACION PËRSHKRIMOR**

### **OBJEKTI**

**“Përmirësim i shtresës asfaltike në disa segmente në qytet”**

#### ***Të përgjithshme:***

Janë parashikuar në total për ndërhyrje disa segmente rrugore të cilat janë të shpërndara në bashkinë e Patosit për të cilat ka patur ankesa të vazhdueshme nga ana e banorëve të cilët cdo ditë përballeshin me mungesën e infrastrukturës rrugore. Për të gjitha rrugët është vlersuar gjendja aktuale paraqitur në përshkrimin e mëposhtëm dhe janë hartuar preventivat specifike për secilën rrugë duke përcaktuar dhe shtresat përkatëse. Gjithashtu për çdo rrugë është paraqitur planvendosje e detajuar dhe prerje terthore ku tregohen qarte paketa e shtresave me trashësitë përkatëse që do të aplikohet. Paralelisht do të punohet dhe nga Ndërmarrja e Shërbimeve publike për kryerjen e një pjesë të punimeve.

### **1. Rruga “Heronjtë e Linasit”, Patos**

#### ***a. Gjendja ekzistuese***

Rruga ndodhet në Patos dhe është një ndër rrugët kryesore të qytetit. Ajo mundëson kalimin nga rruga “Republika” për në rrugën “Unaza” të cilat janë dy rrugë kryesore të qytetit. Rruga ka një gjatësi  $L=425\text{m}$ ,  $b=5.20\text{ m}$ .

Gjendja aktuale e kësaj rruge është në kushte jo të mira për arsye se në këtë segment nuk është ndërhyrë prej vitesh dhe shtresat asfaltike kanë degraduar me kalimin e kohës si pasojë e kalimit të makinave me tonazh të lartë pasi në këtë rrugë ndodhet dhe agjencia e shërbimeve publike Patos e cila vazhdimisht për të realizuar punimet i nevojiten materiale ndërtimore. Nga ana tjetër kjo rrugë u shërben qytetarëve për qarkullimin dhe lidhjen me pjesë të tjera të lagjes për kryerjen e veprimtarive të përditshme si dhe bizneseve të zonës për kryerjen e aktiviteteve të tyre.





Foto-Gjendja Ekzistuese

### *b. Përshkrim i ndërhyrjes që do të realizohet*

Rruga “Heronjte e Linasit” ka një gjatësi prej 450 m karrexhata dhe gjerësi mesatare rruge 5.20m. Ajo është e paisur në të dyja anët me bankinë  $b=50\text{cm}$  dhe trotuar  $b=150\text{cm}$ . Punimet për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e zonës fillimisht janë kryer nga Agjencia e Shërbimeve e cila ka realizuar sistemimin e trotuarit përgjatë gjithë gjatësisë së rrugës. Ndërhyrja në këtë rrugë parashikon rikonstrukcionin e paketës së shtresave rrugore, ku fillimisht do të realizohet skarifikimi i shtresave ekzistuese të binderit dhe asfaltobetonit, pastrimi dhe sistemi i zonës përreth dhe me pas realizimi i punimeve sipas shtresave përkatëse të përcaktuara në projekt. Segmenti i rrugës do të pajiset me paketen e shtresave: Binder  $t=5\text{ cm}$ , Asfaltobeton  $t=4\text{cm}$ .



## **2. Degëzimi i rrugës “Sulo Goxhaj”, lagjja “Naftëtari”**

### *a. Gjendja aktuale*

Rruga ndodhet në lagjen “Naftëtari” e cila aktualisht po i nënshtrohet rikonstrukcionit në pjesën më të madhe të saj nga zbatimi i projektit për “Rikonstrukcion i bllokut përpara pallatit të kulturës” po ashtu me financimin e FSHZH është rehabilituar e gjithë fasada e pallatit. Aktualisht sheshi para pallatit është në gjendje të keqe, pasi është ndërhyrë duke liruar të gjitha hapësirat e zëna dhe i gjithë sheshi ka nevojë për sistemim. Banorëve u mungojnë hapësirat e nevojshme për qarkullimin e makinave, këmbësorëve, hapësira të gjelbra dhe pushimi. Për sistemimin e zonës po punon paralelisht dhe Ndërmarrja e shërbimeve publike për kryerjen e disa nga punimeve deri në përgatitjen e zonës për realizimin e ndërhyrjeve të parashikuara në projekt.




Foto-Gjendja Ekzistuese

*b. Përshkrim i ndërhyrjes që do të realizohet*

Ndërhryja në këtë zonë parashikon rikonstruksionin e paketës së shtresave rrugore në një sipërfaqe prej 1300 m<sup>2</sup>. Do të realizohet pastrimi i zonës dhe rehabilitimi sipas projektit duke parashikuar të gjitha shërbimet e munguara të banorëve.

Segmenti i rrugës do të pajiset me paketën e shtresave: Binder t=5 cm, asfaltobeton t=3 cm.



### 3. Rruga “Shpiragu”, Lagjja e “Re”

#### *a. Gjendja aktuale*

Rruga ndodhet në lagjen e Re dhe ka gjatësinë prej  $L=110\text{m}$ ,  $b=3.50\text{m}$ .

Gjendja aktuale e kësaj rruge është në kushte jo të mira për arsye se në këtë segment nuk janë bërë ndërhyrje prej vitesh duke sjellë degradimin total të shtresave rrugore.

Kryesisht kjo rrugë u shërben banoreve të zonës për qarkullimin dhe lidhjen me pjesë të tjera të zonës për kryerjen e veprimtarive të përditshme.



Foto-Gjendja Ekzistuese

#### *b. Përshkrim i ndërhyrjes që do të realizohet*

Ndërhyrja në këtë rrugë parashikon rikonstruktionin e paketës së shtresave rrugore në një gjatësi prej 110 m. Do të realizohet skarifikimi i shtresës ekzistuese, pastrimi dhe sistemi i zonës përreth dhe më pas realizimi i punimeve sipas shtresave përkatëse të përcaktuara në projekt.

Segmenti i rrugës do të pajiset me paketën e shtresave: Cakëll  $t=15\text{cm}$ , stabilizant  $t=10\text{cm}$ , Binder  $t=5\text{ cm}$ , asfaltobeton  $t=3\text{cm}$ . Pas lirimit të hapësirave publike ndërhyrja parashikon rehabilitimin e rrugës duke iu ofruar qytetarëve shërbimet e munguara dhe të dedikuara për kalimin e makinave, këmbësorëve dhe hapësira për parkim me një sipërfaqe prej  $325\text{ m}^2$ . Rruga do të jetë e paisur në njërin anë më kuletë për largimin e ujrave të shiut me puseta shimbledhëse (40x40)cm.



#### 4. Segmenti i rrugës “Shëtitorja” dhe “Sulo Goxhaj”.

##### *a. Gjendja aktuale*

Rruga shëtitorja është rruga kryesore e qytetit që përballon fluksin ditor me të lartë të mjeteve që frekuentojnë qytetin e Patosit. Rruga “Sulo Goxhaj” po ashtu është një degëzim në rrugën “Shëtitorja” dhe mundëson lëvizjen e qytetarve për në rrugën kryesore. Prej vitesh nuk janë bërë ndërhyrje në këto segmente duke u bërë pengësë për qarkullimin e përditshëm të banorëve. Segmenti prej 240 ml do të nënshtrohet ndërhyrjes duke realizuar skarifikimin e shtresave dhe riveshjen e tyre, po ashtu tek ky segment do të mundësohet zgjerimin i karrexhatës duke lehtësuar qarkullimin dhe krijimin e hapësirave anësore për parkim.


Rruga “Sulo Goxhaj” do të nënshtrohet ndërhyrjes prej 300 ml duke skarifikuar shtresat asfaltike dhe zëvendësimin e tyre.



Foto-Gjendja Ekzistuese

*b. Përshkrim i ndërhyrjes që do të realizohet*

Ndërhyrja në këto rrugë parashikon rikonstruksimin e paketës së shtresave rrugore në një gjatësi prej 540 ml. Do të realizohet skarifikimi i shtresës ekzistuese, pastrimi dhe sistemi i zonës përreth dhe më pas realizimi i punimeve sipas shtresave përkatëse të përcaktuara në projekt. Segmenti i rrugës do të pajiset me paketen e shtresave: Cakëll  $t=15\text{cm}$ , stabilizant  $t=10\text{cm}$ , Binder  $t=6\text{ cm}$ , asfaltobeton  $t=4\text{cm}$ . Rruga do të pajiset me parkime me gjerësi 2.4m.



Hartoi:

Ing. Ermenita Mici

Ing. Boreta Murati